



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes inauguruese të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 07.12.2021, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Përparim Rama, kryetar i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit të Komunës: Nora Kelmendi, Arbër Vokrri, Berat Lahu, Ermal Osmani, Feim Osmani, Gezim Sveçla, Tria Kasumi-Berisha, Rashit Gashi, Petrit Reçica, Mirsad Vitija, Besnik Mujeci, Violeta Salihu, Besart Krasniqi, Berna Saraçi, Rita Zariqi, Arbnora Berisha, Fehmi Kupina, Alban Zogaj, Jeta Rafuna-Hasani, Krenar Xhaferi, Izet Sadiku, Milazim Vitija, Donat Lushaku, Fadil Aliu, Fisnik Osmani, Lindita Rexhepi, Donjeta Dragusha, Elmire Nikçi-Rexha, Dhurata Jahaj-Retkoceri, Ilirik Musliu, Granit Geci, Leutrim Retkoceri, Agron Canolli, Plator Gerdovci, Kumrije Shabani-Ramadani, Shegë Beqiri-Badivuku, Endrit Gashi, Bahri Gashi, Kushtrim Mushica, Valbona Ajeti, Gëzim Mehmeti, Fiknete Bejta, Sami Boroci, Endrit Zabërgja dhe Agim Kuleta.

Të pranishëm ishin edhe: Shpend Ahmeti, ish-kryetar i Komunës, ish-nënkryetarët e Komunës, Muhedin Nushi dhe Selim Pacolli, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi Luljeta Selimi, u.d. e shefit të Sektorit për punë të Kuvendit, e cila fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit, veçanërisht anëtarët e Kuvendit, duke u dëshiruar mirëseardhje në Kuvendin e Komunës. Në vazhdim ajo tha se, në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale për mbajtjen e mbledhjes inauguruese, parashihet, që seancën ta udhëheq anëtari më i moshuar nga radhët e anëtarëve të Kuvendit, e që është z. Milazim Vitija.

Milazim Vitija fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit, e në veçanti anëtarët e Kuvendit dhe kryetarin, z. Përparim Rama. Para se të ftohen anëtarët e Kuvendit për betimin para Kuvendit, ai kërkoi që të formohet një komision verifikues, me përbërje nga të gjitha partitë politike të përfaqësuara në Kuvend, për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Kuvendit.

Për anëtarë të Komisionit u propozuan: Berat Lahu, LVV, Jeta Rafuna-Hasani, LDK, Agron Canolli, PDK, Kushtrim Mushica, AAK, Sami Boroci, AKR dhe Endrit Zabërgja-Nisma.

Faqe Inga2

Komisioni konstatoi dhe bëri verifikimin e mandateve, ku prej 51 anëtarëve të zgjedhur, prezent ishin 48 anëtarë, ndërsa 3 munguan: Arben Vitija, LVV, Daut Haradinaj AAK dhe Rinë Limani, PDK.

Kryesuesi më pas ftoi anëtarët e Kuvendit që të bëjnë betimin para Kuvendit.

Pas betimit të anëtarëve të Kuvendit, betimin para Kuvendit të Komunës e bëri edhe z. Përparim Rama, kryetar i Komunës së Prishtinës.

Përparim Rama, kryetar, i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrje në këtë ceremoni solemne të betimit të anëtarëve të Kuvendit të ri të Komunës së Prishtinës dhe betimin e tij për kryetar, duke thënë se kjo detyrë e cila më është besuar mua, është obligim serioz dhe sfidë e madhe, të cilës do t'i vihemi përpara me punë të ndershme, profesionalizëm dhe dinjitet.

Në fjalën përmbyllëse, kryesuesi falënderoi të gjithë ata që morën pjesë në këtë seancë solemne të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja mbaroi në orën 11:40.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**



Faqe2nga2